

KONTRIBUTI I RAMI MEMUSHAJT PËR SHQIPEN STANDARDE

Izmit DURMISHI¹

¹Gjuhë dhe letërsi shqipe – Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

e-mail: izmit.durmishi@unite.edu.mk

Abstrakt

Përvetësimi i shqipes standarde është proces që fillon herët, qysh në arsimin fillor, vazhdon në atë të mesëm dhe universitar, për të mos u ndalë kurrë. Themi kështu për arsye se, gjuha është materie e gjallë që ndryshon, zhvillohet e pasurohet, prandaj ajo përvetësohet vazhdimisht. Kumtesa që po shtjellojmë, në radhë të parë, synon të nxjerrë në dukje kontributin e gjuhëtarit tonë të mirënjohur Rami Memushaj i cili rrëfeu në mënyrë dinjitoze rrugën e gjatë e të mundimshme të zhvillimit të gjuhës standarde shqipe. Ai na këshillon që standardi i shqipes së sotme mund dhe duhet të përparohet vetëm me energji pozitive, duke parë me kujdes gjithçka që i shkon për shtati natyrës dhe normës së saj. Shpjegon në mënyrë të argumentuar rrugën e mundshme të pasurimit, ruajtjes dhe kultivimit të saj dhe kundërshton të gjitha ato orvatje të pabaza të mendësisë prapavajtëse. Po të vërejmë me kujdes sidomos gjuhën e folur e të shkruar të institucioneve me ndikim: shkollës, masmediave të shkruara dhe elektronike etj., do të vijmë në përfundim se, shmangiet e normës së shqipes standarde, janë nga më të ndryshmet. Ato vërehen në rrafshin drejtshkrimor fonetiko-fonologjik, gramatikor, leksikor, si dhe në përdorimin e panevojshëm të fjalëve të huaja në vend të fjalës shqipe. Autori në tekstet dhe shkrimet e tij për shqipen standarde, përpos tjerash, flet edhe për çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore, duke analizuar edhe shkaqet e thyerjes së saj. Kësisoj, përmes shembujve konkretë dhe analizës së thukët nëpër rrafshet e ndryshme gjuhësore, jep shpjegime për kahjen e zhvillimit të shqipes standarde. Përpjekjet e tij për ruajtjen, pasurimin dhe kultivimin e shqipes së normëzuar letrare, janë treguesi më i qartë që na mëson se si duhet folur dhe shkruar shqipja standarde. Zotërimi i shqipes standarde është proces që kërkon mund dhe angazhim të pandërprerë, prandaj, të gjithë jemi të obliguar të bëjmë përpjekje që ta zotërojmë atë sa më mirë.

Fjalë kyçe: gjuhë letrare (standarde), përvetësim, normë, rrafshe gjuhësore, shkollë, gazetë, drejtshkrim.

Abstract

The acquisition of standard Albanian is a process that begins early from the elementary education and continues into secondary and university education which never stops. This proves to be so because the language is a living matter that changes, develops and enriches itself and it is constantly acquired. This research being carried out, first and foremost, aims to highlight the contribution of our well-known linguist Rami Memushaj who dignified the long and laborious path of development of standard Albanian language. He advises us that the standard of today's Albanian language can and should be advanced only with positive energy, carefully observing everything that suits its nature and norm. It arguably explains the possible path of its enrichment, preservation and cultivation and rejects all those baseless attempts of the back mindset. If we carefully look at the spoken and written language of the influential institutions: the school, the written and electronic media, etc., we will come to the conclusion that deviation from the standard Albanian norm are the most varied. They are observed in the phonetic-phonological, grammatical, lexical spelling, as well as in the unnecessary use of foreign words instead of the Albanian word. The author in his texts on standard Albanian, among other things, also speaks on issues of morphological and spelling norms, analyzing the causes of its breaking. Thus, through concrete examples and in-depth analysis across the different linguistic fields, it provides explanations for the development of standard Albanian. His efforts to preserve, enrich and cultivate literary standardized Albanian are the clearest indication that teaches us how to speak and write standardized literary Albanian. Mastering standard Albanian is a process that requires continuous effort and commitment, so we are all bound to make the effort to master it well.

Keywords: literary (standard) language, acquisition, norm, language level, school, newspaper, spelling.

Hyrje

Gjuhëtari ynë i mirënjohur Rami Memushaj, përpos teksteve nga fusha të ndryshme gjuhësore, siç janë: *Morfonologji e eptimit të gjuhës shqipe* (1989), *Hyrje në gjuhësi* (2002), *Fonetika e shqipes standarde* (2003), *Gjuhësia gjenerative* (2003), *Teste gjuhësore* (2003), *Bukuria e gjuhës* (2007), *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe* (2011) etj., hartoi edhe një numër të konsiderueshëm tekstesh të rëndësishme për shqipen standarde, gjegjësisht për çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore, si dhe për planifikimin (politikën gjuhësore) të shqipes. Në këtë kumtesë do të trajtojmë disa pikëpamje të autorit, mjaft të rëndësishme dhe domethënëse në fushën e standardit të shqipes. Me zellin e një studiuesi të rallë, me përvojën e madhe si mësimdhënës, autori nxori në pah, në radhë të parë, tekstin domethënës universitar *Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë?* (2002), libër ky që u mirëprit nga specialistët e gjuhës dhe lexuesit shqiptarë për mënyrën e trajtimit dhe përmbajtjen e pasur. Çështja e standardit të shqipes që është preokupim i kahmotshëm i autorit, si dhe shumë çështje të tjera të gjuhës, që do të trajtohen në vijimësi edhe në dy tekstet pasuese: *Për shqipen standarde I, II - Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore* (2012).

1. Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë?

Në një kumtesë si kjo që po shqyrtojmë, pothuajse është e pamundur të përfshihet kontributi që ka dhënë dhe po jep për shqipen standarde profesor Rami Memushaj. Le t'i kthehemi për një çast veprës së tij madhore e ta falënderojmë autorin, për të gjithë atë që ka bërë dhe po bën për shqipen, gjuhëtari, studiuesi, profesori dhe njeriu udhërrëfyes për studiuesit e rinj të gjuhësisë shqiptare. Libri i profesor Rami Memushajt *Shqipja standarde (Si ta flasim dhe ta shkruajmë?)*¹⁰ është tekst mjaft voluminoz dhe përmbajtësor i këtij lloji, që ka dalë si fryt i përvojës së madhe shumëvjeçare të autorit në mësimdhënie. Ai paraqet një pasqyrë të plotë dhe konkrete për zbatimin e rregullave të shqipes së njësuar. Teksti ngërthen në vete pothuajse mbarë brumin e shqipes, duke e ndarë atë në klasa fjalësh e rregullash që kërkon të mësuarit e shqipes dhe normat e saj. Rëndësia e tij qëndron edhe në faktin se, autori i librit është përpjekur të trajtojë disa çështje problemore të gjuhës, që nuk i njohim sa duhet. Autori ofron zgjidhje për pikëpamje të diskutueshme normative dhe për luhatje që karakterizojnë normën e gjuhën letrare, qoftë në ligjërimin e folur apo të shkruar. Ai di të japë zgjedhje të pëlqyeshme për çështje të caktuara të normës së shqipes, në përputhje me traditën, rregullat dhe përdorimin e saj të përgjithshëm. Di të njohë thellë natyrën e shqipes dhe rregullat që kërkon ajo për njësimit të arritur, andaj edhe kurorëzon mbarështimin e një teksti, ndër më të mirët që ka shqipa standarde sot.

Përpos tjerash, libri ka vlerë të posaçme, pasi në të janë përfshirë edhe mjaft rregulla që nuk gjenden ndoshta në kodet normative të shqipes. Me këtë shihet prirja e autorit për të ndihmuar e plotësuar standardin e shqipes. Libri shquhet për mënyrën e përpunimit dhe klasifikimit të materialit gjuhësor, duke ofruar kështu një pasqyrë të plotë për artin e të shkruarit, normën gramatikore, drejtshkrimin dhe pikësimin. Në të autori shtjellon çështjen e standardit të shqipes, në formën e folur dhe të shkruar dhe orvatet t'i sqarojë mirë rregullat normative që të jenë të

¹Rami Memushaj, *Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë?*, Tiranë, 2002.

kuptueshme për lexuesin. Që në fillim të tekstit kuptojmë udhëzimet e fisme të tij, për ta zotëruar standardin e shqipes në të dy format, e sidomos formën e shkruar të tij, pasi të shkruarit e shqipes së normëzuar është nevojë e pashmangshme e përditshmërisë sonë.

Që në pjesën e parë të tekstit, autori ngriti problemin e hartimit të një shkrimi, duke filluar nga kërkimi i literaturës, grumbullimi i materialit faktik e deri te redaktimi gjuhësor i tij. Në pjesën vijuese pasqyrohen çështje të normës morfologjike e sintaksore, sidomos ato vështirësi e luhatje në zbatimin e normës, që kanë sidomos pjesët e ligjëratës, si emri, përemri, folja etj., nëpër kategori gramatikore. Ngjajshëm pasqyrohen edhe çështje sintaksore, si rendi i fjalëve, përshtatja e gjymtyrëve në fjali, si dhe shmangia nga ndërtimet e huaja strukturore. Në vazhdim, teksti pasqyron një punë të zellshme të autorit e cila përkon me drejtshkrimin e shqipes standarde nëpër të gjitha rrafshet gjuhësore, si dhe përdorimin e shenjave të pikësimit në fjalinë e thjeshtë, në periudhë dhe në ligjëratën e drejtë.

Autori në tekst, me theks të veçantë ka përmendur edhe lidhshmërinë e gjuhës së përbashkët popullore shqipe me formën letrare e standarde. Dialektet, nëndialektet dhe të folmet e ndryshme ndër shqiptarë, i sheh si burim për pasurimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe. Kur flet për normat e shqipes standarde, sqaron saktësisht se, ndër veçoritë e standardit është përdorimi i fjalëve, trajtave e ndërtimeve normative. Autori sqaron se, nga të gjitha trajtat, fjalët, ndërtimet dhe gjedhet fjalëformuese e sintaksore me të njejtën vlerë që përdoren në shqipen, duhet zgjedhur njërën nga ato forma si të pëlqyshme, në bazë të kriterëve të caktuara të natyrës së shqipes, dhe atë formë të përzgjedhur, duhet ngritur në normë. Këtë çështje autori e sqaron duke përmendur shembuj ilustrativë të shqipes, që kanë të bëjnë me kohët e foljeve, të pakryerën dhe të ardhmen e thjeshtë. Ai rrëfen me të drejtë se, e pakryera del në trajtat e ndryshme dialektore, si: *shkonja, shkojë, shkojsha, shkonjam, shkoja* ; ndërkaq e ardhmja e thjeshtë del në trajtat, si *do shkoj, do të shkoj, kam me shkue, kam të shkoj* ¹¹. Nga këto forma të shumta dialektore, si më të përgjithshme në përdorim janë zgjedhur trajtat *shkoja*, përkatësisht *do të shkoj*, pohon autori. Pra, nga format e sipërshënuara foljore kuptojmë se, *me normë duhet kuptuar jo vetëm trajtat, fjalët, ndërtimet dhe gjedhet fjalëformuese e sintaksore më të përhapura që shpallen si të detyrueshme për t'u përdorur nga gjithë folësit e një gjuhe, por edhe tërësinë e rregullave mbi përdorimin e tyre* ¹².

Për zotërimin e suksesshëm të standardit në formën e folur dhe të shkruar, duhet njohur normat drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore si kode dhe kode të tjera, sidomos për formën e shkruar të shqipes, siç janë “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, “Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe”, “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe”, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” etj., gjegjësisht normat që veprojnë mbi rrafshet boshte të gjuhës letrare e standarde, siç janë: norma fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore.

Përvetësimi i rregullave drejtshkrimore të një gjuhe dhe zbatimi i tyre praktik nuk është çështje e lehtë. Për këtë proces në radhë të parë duhet njohur rregullat e drejtshkrimit, për të vazhduar me formimin e shkathtësive dhe shprehive për të shkruar drejt e pa gabime. Lidhur me normat e gjuhës standarde shqipe, libri ofron njohuri e të dhëna të bollshme për fonetikën, gramatikën e

² Rami Memushaj, *Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Tiranë, 2002, f.51

³ Po ai, po aty.

leksikologjinë, si disiplina të rëndësishme gjuhësore. që mund t'u hyjnë në punë nxënësve, studentëve, specialistëve të gjuhës e mbarë lexuesve. Falë përfitimit të njohurive të mjaftueshme për normat e rrafsheve të përmendura të gjuhës, përvetësojmë edhe shprehitë e duhura drejtshkrimore.

Në vazhdim të tekstit shohim, trajtimin e thellë dhe të qartë të të gjitha rrafsheve gjuhësore, duke u ndalur kryesisht në sistemet më të gjera të shqipes së njësuar, edhe atë: në sistemin emëror, përemror e foljor dhe kategoritë e tyre gramatikore.

2. Për shqipen standarde I (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore)

Prirja studimore dhe dëshira e madhe e autorit, për t'i bërë sa më të thjeshta dhe të kuptueshme për lexuesin dukuritë gjuhësore që karakterizojnë standardin, vazhdojnë të trajtohen edhe në dy librat vijues për standardin e shqipes. Falë përgatitjes së admirueshme profesionale dhe formimit të thellë shkencor, profesor Rami Memushaj jep ndihmesë të vyer në trajtimin e shumë dukurive gjuhësore, të bazuara në fakte të gjalla të ligjëritit të përditshëm. Në librin e sipërpërmendur, autori vë në dukje çështje të sistemit të gjuhës standarde, apo siç i quan ai “çështje të korpusit” të shqipes standarde. Nga shembujt dhe dukuritë e ndryshme gjuhësore që ka trajtuar në libër, autori na e bën me dije se shqipja letrare e standarde dhe norma e saj e kanë zanafillën shumë herët. Edhe pse standardizimi i shqipes u kurorëzua me Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë më 1972, ai vazhdon pandalshëm të zhvillohet e të plotësohet edhe sot e kësaj dite si proces, pasi gjuha është materie e gjallë që ndryshon e plotësohet. Për nivelin e këtij normëzimi dhe standardizimi të shqipes, duhet kujtuar sidomos historina e zhvillimit të gjuhës letrare nga periudha e Rilindjes, kur shqipja letrare shkruhej në dy variante letrare: në gegërishte letrare dhe në toskërishte letrare. Vetë Konstandin Kristoforidhi shkroi në të dy variantet letrare dhe me këtë vërtetoi bindshëm se këto ishin variantet letrare të një gjuhe të vetme kombëtare, të cilët një ditë, duke u ofruar njëri me tjetrin do të përfundojnë në një gjuhë të vetme kombëtare.

Për mbarëvajtjen e procesit të normëzimit dhe standardizimit të shqipes nga e kaluara e deri në ditët tona, s'do harruar për asnjë çast as personalitetet dhe veprat e tyre madhore që e ndihmuan këtë proces. Këtij procesi të rëndësishëm i paraprijnë edhe ngjarjet madhore, siç janë: Kongresi i Manastirit (1908), Kongresi i Elbasanit (1909), Komisia Letrare e Shkodrës (1916-1918), Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920), Kongresi Arsimor i Tiranës (1922), Kuvendi i Parë i Studimeve Albanologjike (Tiranë, 1940), Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968), Kongresi i Drejtshkrimit (1972).

Vendosmëria e autorit për t'u hyrë në themel shumë çështjeve problemore të normës dhe standardit dhe aftësia për të shpjeguar të njëjtat me argumente bindëse e të bazuara në materialin burimor, janë ndër cilësitë e këtij studiuesi të zellshëm e dinjitoz. Në tekstin e përmendur më sipër, autori vë në dukje disa çështje të rëndësishme të normës morfologjike e drejtshkrimore të shqipes standarde. Kemi përshtypjen se autori thellohet në trajtimin e atyre çështjeve të rëndësishme të normës gjuhësore, për të cilat kanë nevojë lexuesit dhe studiuesit e shqipes. Pasi këto çështje që shtjellon autori janë të shumta për nga numri, dhe që shtrihen në planin sinkronik dhe diakronik, po përmendim vetëm disa nga më të rëndësishmet.

Ndër çështjet e rëndësishme që ngrit autori, duke u bazuar në interesimin e gjuhëtarëve të huaj dhe vendës për shqipen (G.Hani, Sh. Demiraj, I.Ajeti etj.) është çështja e foljeve me temë të zgjeruar më – *as* që përbëjnë një grup të veçantë të foljeve me bashkëtingëllore që pësojnë ndërrime morfologjike¹³. Për të parë ndryshimet që pësojnë këto folje nëpër kategori të ndryshme gramatikore dhe ngritjen – mosngritjen e tyre në normë, si dhe anën e tyre të errët, po japim në vazhdim disa nga shembujt që ka trajtuar autori. Ai ka marrë në shqyrtim 34 folje të tilla dhe, duke parë zgjedhimin e tyre nëpër kohë e mënyra, ka konstatuar se, një numër i madh i foljeve të këtij grupi na dalin me dy tema: me temë të zgjeruar më –*as* dhe me temë të pazgjeruar. Po japim disa shembuj që pasqyrojnë zgjedhimin e foljeve të tilla që ka nënvizuar autori, në kohën e tashme, në të kryerën e thjeshtë dhe mënyrën pjesore: bërtas (brit) – bërtit-a (brit-a) – bërtit-ur (brit-ur), çokas (çok) – çokit-a (çok-a) – çokit-ur (çok-ur), çukas (çuk) – çukit-a (çuk-a) – çukit-ur (çuk-ur), kërcas (kris) – kërcit-a (kris-a) – kërcit-ur (krisur) përkas (prek) – përkit-a (prek-a) – përkit-ur (prek-ur), vërras (virr) – vërrit-a (virr-a) – vërrit-ur (virr-ur)¹⁴ etj.

Ajo që shpjegon në mënyrë të thukët autori është se, një pjesë e foljeve të tilla nuk përbëjnë normë në gjuhën e sotme. Trajtat e shënuara në kllapa në shembujt e mësipërm janë jonormative, ose variante të normës. Sipas autorit, edhe profesor Çabej kishte pohuar se nga foljet më –*as*, nuk janë dhënë *vras*, e prejardhur nga *varrë* me formantin –*as*, dhe *ngas* e *shkas*¹⁵, të dyja me etimologji të errët, të cilat sot i përkasin një gjedheje tjetër morfonologjike. Lidhur me foljet e grupit të tillë, mund të nxjerrim konkluzat, si në vijim: **a)** disa nga foljet e grupit të tillë, nga pikëpamja e origjinës nuk janë të qarta sa duhet, disa të tjera u përkasin dialekteve e të folmeve (janë jonormative), e ca të tjera janë ngritur në normë; **b)** klasën e foljeve me temë të zgjeruar e përbëjnë grupi i parë i foljeve që dalin *me dy trajta* në të gjithë paradigmen: 1) *bërtas* dhe *brit*, 2) *çokas* dhe *çok*, 3) *çukas* dhe *çuk*, 4) *kërcas* dhe *kris*, 5) *përkas* dhe *prek*, 6) *vërras* dhe *virr*, 7) *këlthas* dhe *klith*, 8) *këllas* dhe *kall*, 9) *mërdhas* dhe *mardh*, 10) *pëlças* dhe *plas* etj.; **c)** grupi i dytë i foljeve përfshinë foljet (1) *shklas* dhe *shkal*, (2) *shtërras* dhe *shter(r)*, (3) *gërshas* dhe *grish*, (4) *humbas* dhe *humb*, (5) *flas* dhe *fol*, për të cilat në kohën e tashme vërtetohen të dy variantet (veçse në gjuhën e sotme letrare fjalëformat e së tashmes e të kohëve që rrjedhin nga ajo nuk përdoren, duke u ruajtur aty-këtu në ligjërimet joletrare). Ndërsa në të tashmen hasim ndryshime, në të kryerën e thjeshtë dhe kohët që ndërtohen prej saj, për të gjitha këto folje del vetëm varianti me temë të pazgjeruar: *shkel-a*, *shter-a*, *grish-a*, *fol-a*; **ç)** në grupin e tretë bëjnë pjesë folje që nuk janë ngritur në normë. Nga pikëpamja e gjenezës, ky është një grup heterogjen që përmbledh folje trajta e vjetër e të cilave del nga ana historike (*gërgas*, *rrëshqas*, *gërhas*, *gërthas* etj.), folje të atilla që as analiza etimologjike nuk ka arritur t'i zbërthejë (*buças*, *kërras*, *trokas*, *zhuzhas*¹⁶etj.).

Dukuri tjetër e rëndësishme gjuhësore së cilës nuk i është dhënë përgjigjja e duhur në veprat normëzuese të shqipes, sipas autorit, është edhe çështja e përdorimit të trajtave dysore të

¹⁴ Rami Memushaj, *Për shqipen standarde I (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore)*, Tiranë, 2012, f.11

¹⁵ Po ai, po aty, f.13

¹⁶ Po ai, po aty, f.14

¹⁷ Rami Memushaj, *Për shqipen standarde I (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore)*, Tiranë, 2012, f.16

kallëzores së emrave *përruan* dhe *përroin*, *babanë* dhe *babain*, *dhenë* dhe *dheun* etj. Ajo që preokupon autorin është se: cila trajtë e këtyre dysorëve është normative e cila jo? Siç duket, ai ka shfletuar më shumë gramatika dhe fjalorë, për të parë trajtat e drejta normative. Në vazhdim po përmendim disa tekste që ka vështuar dhe analizuar autori, për të parë trajtat normative dhe jonormative të fjalëve. Në tekstet “*Gjuha letrare shqipe për të gjithë*”, shpjegohet se kallëzorja e shquar njëjës e emrave mashkullorë që mbarojnë me *-a* të theksuar (tipi *vëlla-i*), marrin mbaresën *-në* dhe jo *-in*, pra *babanë* dhe jo *babain*, *vëllanë* dhe jo *vëllain*, etj.; për disa emra të tjerë mashkullorë me temë me zanore të theksuar thuhet se kallëzoren e shquar e formojnë me mbaresën *-un* dhe jo *-në*, d.m.th. *dheun* dhe jo *dhenë*, *bariun* dhe jo *barinë* etj. Autori shpjegon se, trajtat me mbaresën *-në* për këta të fundit pranohen vetëm në frazeologji, si: *mori fjala dhenë* (jo *dheun*), *I bën hesapet pa hanxhinë* (jo *hanxhiun*) etj. Kurse emrat që mbarojnë me grupin zanor *ua* të (tipi *ftua-ftoi*), në kallëzore të shquar pranohen në të dy trajtat (*ftuan* dhe *ftoin*, *përruan* dhe *përroin* etj.), duke këshilluar që “nga këto trajta duhet parapëlqyer të parat, si më të përhapura në gjuhën letrare”⁷.

Autori pohon se i njëjti qëndrim mbahet edhe në “Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe dhe në tekstin “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe” (II) për emrat mashkullorë me temë me zanore të theksuar, duke pranuar vetëm trajtat *vëllanë*, *babanë*, *kaun*, *dheun*, *bariun* etj. Ndërkaq, për emrat që mbarojnë me togun *ua*, “Fjalori drejtshkrimor” jep si trajta të kallëzores së shquar vetëm *ftuan*, *përruan* etj., kurse “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe”(II) pranon si trajta normative ato me ndërrimin *ua~o*: *ftoin*, *përroin* etj. Sipas asaj që shpjegohet në tekstet e sipërsënuara, lidhur me emrat dhe kategoritë e tyre gramatikore (rasën, trajtën), autori konstaton se, qëndrimi më i drejtë për këtë çështje mbahet në Gramatikën e Akademisë, ku si trajtë e vetme e kallëzores së shquar të këtyre emrave jepet ajo me ndërrim në temë: *ftoin*, *kroin*, *thoin* ¹⁷. Ashtu si trajtat *dhenë*, *kanë* etj. *ua* kanë lënë vendin trajtave *dheun*, *kaun* etj., edhe trajtat e emrave *babanë*, *vëllanë*, *xhaxhanë* (edhe pse në gramatikat e sotme vlerësohen si normative), do t’ua lënë vendin dalëngadalë trajtave më të drejta *babain*, *vllain*, *xhaxhain*.

Në pamundësi për t’i përmendur të gjitha çështjet që trajton autori në tekst, siç e thamë edhe në fillim, në vijim të punimit po përmendim shkurtazi disa çështje të rëndësishme që ngërthen libri, lidhur me normëzimin e shqipes. Siç dihet, sistemi foljor është ndër sistemet më të gjera të morfologjisë së shqipes, krahas atij emëror, prandaj në vazhdim të punimit po përmendim edhe disa dukuri gjuhësore që karakterizojnë librin në fjalë, e që kanë të bëjnë me normën morfologjike të shqipes letrare e standarde, që përmend autori. si: Lëvizjet në sistemin foljor të shqipes (lëvizjet e mbaresave të zgjedhimeve të veçanta, lëvizjet e vokalizmit të rrënjës – ndërrimet morfologjike, lëvizjet e derivacionit foljor, lëvizjet e tipave të zgjedhimeve), Çështje të normës morfologjike në fjalorët shpjegues të shqipes, Nga gramatika përshkruese te gramatika normative etj.

Çështje të rëndësishme në tekst paraqesin edhe pikëpamjet e autorit që ka shprehur lidhur me vendin që zë drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në tërësinë e normave të gjuhës letrare. Siç dihet, gjuha standarde përdoret në formën e shkruar dhe të folur. Këto dy forma të përdorimit kanë

⁷ Po ai, po aty, f.26

norma të përbashkëta dhe norma të veçanta. Të përbashkëtat për të dy format janë norma gramatikore (me ca ndryshime në normën sintaksore), norma fjalëformuese dhe norma leksikore. Të veçanta për formën e shkruar janë norma drejtshkrimore dhe e pikësimit, kurse për normën e folur norma e drejtshqiptimit. Ligjërimi i shkruar bie në sy më tepër sesa ai i folur. Prandaj, lexuesi i rëndomtë është i prirur në fillim, t'i dallojë gabimet e drejtshkrimit, ndërkaq ato që lidhen me normën leksikore, morfologjike e sintaksore, me pikësimin etj, ai nuk i vëren. Ato gabime mund t'i vërejnë specialistët e fushës dhe ato të cilët kanë një përvojë të gjatë në punët e shkrimit. Vështirë të kujdesëm autori u ka bërë edhe temave që lidhen me drejtshkrimin e shqipes, si: drejtshkrimit të zanores ë të patheksuar, theksit të fjalëve në gjuhën shqipe, shkronjës së madhe në emërtimet gjeografike, rregullave të pikësimit në gjuhën letrare shqipe; si dhe ka shkruar për “Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe” (2011) etj.

3. Për shqipen standarde II (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore)

Afinitetin e një studiuesi të vëmendshëm e plot përkushtim, lidhur me planifikimin gjuhësor të shqipes – këtij procesi kaq të ndërlikuar, e vërejmë në trajtesat e shtjelluara gjerësisht në librin vijues të tij. Prurjet e reja ideore, metodologjike e praktike të autorit, për një zgjidhje fatlume të çështjes së politikës gjuhësore shqiptare, paraqesin pikëpamje mjaft serioze për zgjidhjen e planifikimit gjuhësor deri në ditët e sotme. Ai njëkohësisht është hartues i shumë teksteve për gjuhën dhe kontribues i denjë në Gramatikën e Akademisë, njohës i thellë i të gjitha fazave të zhvillimit të shqipes, prandaj edhe i planifikimit gjuhësor të saj.

Autori përmend të gjithë intelektualët shqiptarë më të njohur të kohës dhe idetë e tyre, që nga periudha e Rilindjes kombëtare e deri në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), që kontribuan për zgjidhjen e gjuhësinë normative. Ai përmend Sami Frashërin, Faik Konicën, Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabejn, Gjergj Fishtën, Selman Rizën, Arshi Pipën, Dhimitër Shuteriqin etj., për të na ofruar sa më shumë ide për një zgjidhje të qëlluar të planifikimit gjuhësor të shqipes. Pavarësisht se nuk përputheshin idetë e figurave tona të përmendura për planifikimin gjuhësor, megjithatë mbisundoi arsyeja që çon kah unifikimi, e jo nga ndarja. Samiu, sipas autorit, me kohë kishte pohuar se “*gjuha është m’e parë e m’e madhe shenjë e një kombësie*”¹⁸. Edhe Konica dhe Xhuvani kishin kërkuar nevojën e krijimit të një gjuhe letrare të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Unifikimin e dy varianteve letrare në një gjuhë të përbashkët kombëtare e kishte kërkuar edhe Konstandin Kristoforidhi, siç e theksuam më lart. Pikëpamje të ngjashme kishte shprehur edhe profesor Çabej i cili thekson se “*me formimin e shtetit shqiptar edhe gjuha shqipe ka marrë dhe ka për të marrë edhe më shumë një zhvillim tjetër, një zhvillim konvergjent të dialektevet*. Dhe kjo rrugë duhet të ndiqet, sepse një shtet unitar nuk mund të mendohet pa një gjuhë unitare”¹⁹ nënvizon profesor Rami Memushaj.

Duhet theksuar njëkohësisht se, rrugën e normëzimit të shqipes e karakterizuan edhe idetë, që në një mënyrë ose tjetër, e frenonin mundësinë dhe nevojën e planifikimit gjuhësor të shqipes. Rol dominant për këtë ngadalësim të procesit të politikës gjuhësore, luante lokalizmi si faktor apo

¹⁸ Rami Memushaj, *Për shqipen standarde II (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore)*, Tiranë, 2012, f.16

ndjenjë që i karakterizon shqiptarët. Ata që insistonin të vihet njëri apo tjetri dialekt si bazë e gjuhës së përbashkët kombëtare, e kishin gabim. Siç përmend edhe profesori, vija e përafrimit të shqipes e mbajtur nga rilindësit u ndoq në vazhdimësi si më e qëlluara. Një hapërim që u bë drejt normëzimit të shqipes, doli si rezultat i natyrshmërisë së saj dhe kontributit të gjuhëtarëve që i njihnin më thellë këto çështje. Autori na këshillon t'i kujtojmë sidomos tri data që shënojnë tri pika të rëndësishme në praktikën e planifikimit gjuhësor të shqipes: sesionet shkencore të vitit 1952, Konsultën gjuhësore të Prishtinës më 1968 dhe Kongresin e Drejtshkrimit më 1972.

Kur bën fjalë për teorinë e planifikimit gjuhësor në të ardhmen, ai parasheh si të domosdoshëm vlerësimin dhe rivlerësimin e normës. Por, që ky vlerësim të jetë dobirurës, gjithsesi duhet të mbështetet në synime të qarta. Synimi parësor i politikës gjuhësore duhet të jetë vënia në pah e varianteve normative në rrafshin e normës drejtshkimore, morfologjike, sintaksore e leksikore, të mbështetura edhe në traditën e mëparshme letrare dhe në ligjërimet e sotme dialektore. Në funksion të zbatimit të gjuhës mbarëkombëtare, autori përmend formimin e një akademie gjuhësore gjithëshqiptare, roli i së cilës do të ishte përvetësimi dhe zbatimi i normës gjuhësore në ligjërimin e shkruar dhe të folur.

Referencat

- [1].Memushaj, Rami, *Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë?*, Tiranë, 2002.
- [2].Memushaj, Rami, *Për shqipen standarde I (Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkimore)*, Tiranë, 2012.
- [3].Memushaj, Rami, *Për shqipen standarde II (Çështe të normës morfologjike e drejtshkimore)*, Tiranë, 2012.
- [4].Shkurtaç, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip*, Toena, Tiranë, 2008.
- [5].Rrokaj, Shezai, *Çështje të gjuhës shqipe 4*, Tiranë, 2018.